Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0626

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Zv.Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahimi, paneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së OE " AR & BUS" SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Pajisje Policore për Gjeneratën e 59-të" me numër të prokurimit 214-24-1540-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, më 22/08/2024, mori këtë:

Vendim

1.Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Ar & Bus" Sh.P.K." me nr. 2024/0626 ,e datës 12/07/2024 lidhur me aktivitetin e "Furnizim me Pajisje Policore per Gjeneraten e 59-te" me nr. të prokurimit: "214-24-1540-1-2-1"1 (AK) - Policia e Kosovës,.

2.Mbetet ne fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Policia e Kosovës, në lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërishtë e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

4. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 28.02.2024 Policia e Kosovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me Pajisje Policore per Gjeneraten e 59-te" me nr. të prokurimit: "214-24-1540-1-2-1". Ndërsa me datë 26.06.2024 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate OE "Sodex Group SH.P.K.".

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 119,700.00 € për II Pjesë (Lote) .

Me 01.07.2024 OE "Ar & Bus" Sh.P.K." ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 02.07.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 12.07.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE " AR & BUS" SH.P.K." me nr. 0626/2024 lidhur me aktivitetin "Furnizim me Pajisje Policore per Gjeneraten e 59-te" me nr. të prokurimit: "214-24-1540-1-2-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Ar & Bus" Sh.P.K." janë parashtruar si në vijim:

Sqarim hyrës : "Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS ka udhëhequr aktivitetin e Prokurimit: "Furnizim me Pajisje Policore për Gjeneraten e 59-te" me nr. të prokurimit: "214-24-1540-1-2-1". Me datë 28.02.2024 është publikuar njoftimi për kontratë, Me datë 19.03.2024 Afati për dorëzimin e ofertave, Me datë 02.04.2024 është publikuar Formulari B58 – Njoftimi i pare mbi vendimin e AK, Me datë 19.04.2024 OE Sodex Group SH.P.K. ka paraqitur ankesë pranë OSHP, Me datë 07.06.2024 OSHP ka nxjerrë Vendim për aprovimin e ankesës së OE Sodex Group SH.P.K si të bazuar, Me datë 26.06.2024 është publikuar formulari B58- Njoftimi i dytë mbi vendimin e AK, Me datë 01.07.2024 OE " AR & BUS" SH.P.K. ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim pranë AK, Me datë 02.07.2024 AK ka nxjerrë vendimin mbi refuzimin e kërkesës

për rishqyrtim, Me datë 12.07.2024 OE " AR & BUS" SH.P.K. si palë e pakënaqur ka parashtruar ankesë pranë OSHP."

Pretendimi i parë (I) : "OE ankues nuk pajtohet me vlerësimin e AK, ku shfaq pretendimin e tij se arsyet e eliminimit ku AK e ka njoftuar se ka dështuar ne 2 pjesët e Aneksit 1-Specifikimet teknike ku OE ankues i ndan në : Specifikimet teknike te baterisë që sipas dosjes është kërkuar:"Body: Aircraft grade aluminum with non-slip rubberized comfort grip with anti-roll rubber ring", duke deklaruar se gjatë procesit të tenderimit AK ka dhënë sqarime se do të pranon specifika te cilat tejkalojnë kualitetin e kërkuar, por komisioni vlerësues ka konsideruar se produkti i ofruar nuk i ka plotësuar specifikimet e kërkuara ne Aneksin 1 te DT. Gjithashtu OE ka dështuar edhe në parametrin "Light Source C4 ®LED", ndërsa OE ankues ka ofruar LED por jo edhe C4. OE ankues deklaron se AK në lidhje me këto dy pika në këtë rast është në kundërshtim me LPP gjegjësisht Neni 28 Specifikimet teknike dhe Neni 59 – Vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve. OE ankues në pretendimin ankimor jep edhe sqarimet ku përmes te cilave pretendon se produkti i ofruar nga ai është "Glass filled nylon polymer", material i cili sipas OE ankues dukshëm i tejkalon vetitë e materialit të kërkuar në dosjen e tenderit, duke i dhënë edhe disa specifika qe sipas OE ankues janë me te mira se sa materiali i specifikuar ne DT. Po ashtu jep edhe sqarimet sa i përket "Light Source C4 LED" ku pretendon se C4 është markë e regjistruar tregtare dhe nuk mund të përdoret nga dikush tjetër, duke deklaruar se nëse kërkohet vetëm përshkrimi C4 atëherë në specifikimet teknike janë përshtatur vetëm për prodhuesin Streamlight pasi që asnjë prodhues tjetër nuk mund të ofrojë C4LED dhe kjo sipas OE ankues është në kundërshtim me Nenin 28 të LPPsë. OE ankues ka përshkruar materialin e ofruar nga ai, që i përket prodhuesit Cree LED duke deklaruar qe ky produkt i plotëson çdo performancë të ofruar nga C4 dhe i tejkalon ato, duke e sqaruar edhe standardin për këtë lloj të produktit të cilin e plotëson produkti i ofruar nga OE ankues."

Pretendimi i dyte (II) : "OE ankues në lidhje me pjesën 2 se bateria është kërkuar me dimensione: Diameter of the battery: 2.3 cm Ndërsa OE ka ofruar baterinë me diametër 2.378 cm OE ankues sqaron se edhe gjatë qasjes i kanë dështmuar AK-së se matja prej 2.378 është e gabuar ku deklaron se në faqen zyrtare të prodhuesit për baterinë e brendshme 9600-BATT në specifikimet teknike shkruhet: Diameter: 0.9 in (23 mm) Si dështmi OE ankues ka ofruar edhe linkun për verifikim: https://www.nightstick.com/products/9600-batt."

Pretendimi i trete (III) : "OE ankues nuk pajtohet me arsyet e eliminimit te tij dhe përgjigjet e dhëna nga AK sa i përket artikullit 3 – Qeska për karikator ku ndër të tjera OE ankues konsideron se konstatimet e dhëna nga komisioni vlerësues janë në kundërshtim me Nenin 59 të LPP-së, për arsye se nuk kanë dhënë arsyetim faktik apo të matshëm, por thjeshtë pikëpamje personale të cilat nuk duhet të jenë pjesë e vlerësimit. OE ankues ka dhënë edhe Specifikimet teknike për qeskat e karikatorëve që është kërkuar : Type: Mag Pouch Color: Black Material: Polymer Size: Glocks 19 Model: MP17076 OE ankues ka paraqitur edhe pyetjen ne lidhje me sqarimin e kërkuar ne fazën e tenderimit dhe po ashtu edhe përgjigjen e dhënë nga AK se mund të ofertohet me produkte që i tejkalojnë kërkesat sipas specifikimeve të dosjes. OE ankues ka dhënë përshkrimin e produktit të ofertuar, duke deklaruar që produkti i ofruar është ekuivalent

me modelin e kërkuar në ST të DT MP17076."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE "Ar & Bus" Sh.P.K." konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 28, 59 i LPP-së. Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit qe duke pasur parasysh provat e ofruara me këtë ankese, duke pasur parasysh parimin e kursimit te buxhetit te Republikës se Kosovës, ku oferta jone është dukshëm me e lire se oferta e OE te shpallur fitues, te pranoje ankesën tone si te bazuar dhe te ktheje lenden ne rivlerësim.

Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim: "Autoriteti kontraktues ka përpiluar specifikimet teknike në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Sa i përket specifikacioneve te gjithë OE-te kane pas mundësi te kërkojnë sqarime gjate periudhe sa ka qene aktiviteti i hapur. Andaj pasur kësaj periudhe bazuar ne LPP OE-te duhet te i përmbahen specifikacioneve sipas Aneksit 1 dhe te mos devijojnë. nuk qëndron pasi AK ka vlerësuar ne baze te kritereve te kërkuara ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe ne baze te specifikave teknike te kërkuara ne dosjen e tenderit dhe OE i plotëson te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe specifikat teknike është rekomanduar për kontratë pasi ka qen oferta e përgjegjshme me çmimin me te lirë. OE ankuese ka dështuar ne specifikacionet teknike Aneksi 1 i DT sinë vijim : Body: Aircraft grade aluminum with non-slip rubberized comfort grip with anti-roll rubber ring (Trupi: Alumini i klasës së avionit me dorezë rehati të gomuar që nuk rrëshqet me imazë gome kundër rrotullimit). Edhe pse AK ka dhëne sqarime me datë 05.03.2024 lidhur me ketë parametër, AK ka dhen sqarim qe do te pranon po qesë tejkalon kualitetin por komisioni vlerësues konsideron qe produkti i ofruar nuk i ka plotesuar specifikacionet e kërkuara ne Aneksin 1 te DT. Gjithashtu edhe eksperti shqyrtues ka konstatuar qe mostrat e OE rekomanduar (AR & BUS - Prishtinë) nuk është ne përputhje me Specifiakcionet Teknike te DT dhe kjo është edhe arsyeja kryesore e kthimit te lendes ne rivlerësim ku ne vendim potencohet:Përgjigjes ndaj sqarimit të kërkuar. Eksperti shqyrtues konsideron se produkti i ofruar nga OE i rekonianduar për kontratë në aspektin e materializimit të tnipit të baterisë nuk është në përputhje me Specifikimin teknik të dosjes së tenderit. Gjithashtu OE ka dështuar ne parametrin: Light Source: C4® LED OE ka ofruar LED por jo edhe C4®. Pavarësisht te gjitha arsyetimeve te dhëna nga OE ankuese bateria nuk është sipas specifikacioneve te DT, nuk është Light Source: C4® LED Bateria është kërkuar me dimenzione: Diametër of the battery 2,3cm (Diametri i baterisë). OE beterin te cilën e ka sjelle ka diametër 2.378cm. Me dëshminë e dërguar ne kuadër te kërkesë për rishqyrtim për diametrin e baterisë nga prodhuesi konfirmon qe është 23mm, edhe pse ka mospërputhshmëri me konvertimin ne web faqe te internetit (shih dëshminë): Length t 0.9 = 22.86 Incht Millimeter i nuk është 23 mm. Sa i përket qeskës se karikatorit AK qëndron pran vendimit te datës 26.06.2024 sepse me ilustrim është dhëne ne DT dhe OE ka dështuar për arsye te 1. Ekspozohet shume gjate punës se policit si ne Uniforme e gjithashtu edhe ne rroba civile. 2. Pasi qe është shume e ekspozuar (trashësia e saj) e pengon Zyrtarin Policor ne rrobat e tij sidomos kur ka te veshur Jakne - nuk do ta ndjen veten komod dhe do ta pengoj. Do te dukej shume jo profesional. 3. Gjithashtu pengës paraqet edhe kur Z.P. ndodhet ne automjet, me vendosjen e rripit te sigurisë dhe intervenimit urgjent te Z.P ne ndonjë rast do te ngatërrohet ne rripin e automjetit. Sqarimi i

datës 05.03.2024 lidhur me artikullin, AK ka dhen sqarim qe do te pranon po nëse tejkalon kualitetin por komisioni vlerësues konsideron qe produkti i ofruar nuk i ka plotesuar kërkesat e parapara sipas specifikave te detyrueshme, Aneksi 1 te paraqitur e te cilin AK ka konsideruar te përshtatshme ose te domosdoshme për gjate operimit te punës. E vërtete është qe mostra e sjelle te OE ankuese ka plotësuar përmbajtjen e materialit por ka devijuar nga dizajni i cili është plotësisht jashtë kërkesave te AK-se për arsye te dhëna me lartë ku defekti kryesore është ekspozimi i tepruar. Në vendimin e OSHP-se për OE-ne e rekomanduar (AR & BUS - Prishtinë) potencohet gjithashtu për qeskën e karikatorit: Në funksion të dhënies së përgjigjes ndaj sqariniit të kërkuar Eksperti sqaron se Mostra e ofruar nga OE i rekomanduar nuk është në përputhje me Specifikimin Teknik në DT sipas përshkrimit të sipër cekuar Model: MP17076. Komisioni te vlerësimit ka vepruar konform LPP-se dhe ka respektuar vendimi i OSHP- numër 2024/0343 te datës 07.06.2024 ku e ka aprovuar ankesën e ankuesit dhe e ka kthyer ne rivlerësim Paneli shqyrtues konform sqarimeve të dhëna nga eksperti shqyrtues të datës 03.06.2024 pas verifikimit në vend të mostrave të OE ankues (Sodex Group SHPK), konstaton se të gjitha mostrat e verifikuara janë në përputhje me Specifikimet teknike te dosjes së tenderit. Mbi bazën e te lartcekurave, paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 te LPP-se, dhe se kjo procedure e prokurimi duhet ti nënshtrohet procesit te ri-vlerësimit

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 10/07/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0626/2024, ndërsa me datë 10/07/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0626 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është përgjigjur lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "Ar & Bus" Sh.P.K." eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2024/0626 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): "Duke u bazuar në faktet e bashkëngjitura si nga OE ankues po ashtu edhe në shqyrtimin e mëparshëm të ankesës paraprake dhe verifikimit të mostrave të dorëzuara, eksperti vlerëson se pavarësisht deklarimit të OE ankues se produktet në fjalë të dorëzuara mund t'i plotësojnë karakteristikat funksionale sipas kërkesës, mirëpo dallojnë në disa karakteristika teknike. Eksperti shqyrtues konsideron se këto produkte nuk janë konform përshkrimit të specifikimeve teknike dhe i qëndron deklarimit të mëparshëm nga vet eksperti se produktet në fjalë nuk janë në pajtim me kërkesën e dosjes së tenderit duke e sqaruar se në dosje është kërkuar: "Body: Aircraft grade aluminum with non-slip rubberized comfort grip with anti-roll rubber ring". OE ankues ka ofruar "Glass filled nylon polymer", Po ashtu edhe drita është kërkuar"Light Source C4 ®LED" OE ankues ka ofruar dritën vetëm " LED " Duke u bazuar në këto përshkrim Eksperti konsideron se karakteristikat teknike të këtyre produkteve nuk janë të njëjta me kërkesat e dosjes së tenderit. Në pajtim me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së thuhet se "AK do të konsideroj një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Sa i përket deklarimit të OE ankues se Specifikimet teknike janë përshtatur vetëm për një prodhues për shkak të kërkesës C4, eksperti shqyrtues konsideron se ky pretendim është jashtë afatit në këtë fazë, është dashtë të deklarohet në fazën e tenderimit sipas dispozitave ligjore dhe afateve kohore të përcaktuar. Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor 1 është i pa bazuar.."

Konstatimi i dyte (II) : "Në bazë të verifikimit dhe krahasimit të të dhënave zyrtare nga prodhuesi të deklaruar në linkun e ofruar nga OE ankues, eksperti shqyrtues konsideron se bateria e ofruar nga OE ankues është në pajtim me kërkesën e dosjes së tenderit sa i përket diametrit të deklaruar të baterisë. Dëshmi te dhënat e nxjerra nga linku i prodhuesit i gjeni te bashkangjitura ne ekspertize. Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor 2 është i bazuar. "

Konstatimi i trete (III) : "Duke u bazuar verifikimin dhe kontrollin e mostrave të ofruara nga OE ankues ka dhënë sqarimet së produkti i ofruar nga OE ankues nuk është në përputhje me Specifikimin teknik të dosjes së tenderit ku është kërkuar Model: MP17076 Eksperti i qëndron deklarimit të mëparshëm i cili ka rrjedhë nga verifikimi i mostrave të dorëzuara nga ofertuesi – OE ankues. Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor 3 është i pa bazuar. Pavarësisht deklarimeve të OE ankues se produktet e ofruara nga ai plotësojnë kërkesat dhe janë në pajtim me dosjen e tenderit duke ofruar edhe provat - deklaratat nga prodhuesi se materiali është më i avancuar dhe duke ofruar gatishmërinë për sqarimet shtesë në vërtetimin e argumenteve, eksperti shqyrtues konsideron se produktet e dorëzuara nga OE ankues janë të vlerësuara sipas pretendimeve ankimore dhe konstatimeve të mësipërme."

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues-

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes .

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se ankesa eshte pjesërisht e bazuar.. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin konstatimeve, dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka konstatuar se disa pretendime te operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik "Ar & Bus " Sh.P.K." duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetët në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Policia e Kosovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me Pajisje Policore për Gjeneratën e 59-te" me nr. të prokurimit: "214-24-1540-1-2-1".

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahimi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **" AR & BUS" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: